



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë, më 29.01.2019

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES STATUSORE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, “MBI KRYERJEN E AKSIONEVE NGA AGJENCIA E ROJËS BREGDETARE DHE KUFIRIT EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 29.01.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes statutore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian “Mbi kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojes Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë””

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministrija e Brendshme znj. Rovenë Voda dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, “Mbi kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojes Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo marrëveshje ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën operacionale, për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar si dhe kryerjen e operacioneve të kthimit e të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve. Ratifikimi i kësaj marrëveshje synon:

- rritjen e nivelit të bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e BE-së në kuadrin e menaxhimit të kufijve dhe emigracionit të paligjshëm si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të kthimit e ripranimit;
- pjesëmarrjen në operacione të përbashkëta dhe trajnime;
- rritjen e nivelit profesional të punonjësve të policisë së shtetit dhe përcaktimin e detyrave e të kompetencave për menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave;
- rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e informacionit si dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e aseteve teknike e logjistike edhe në kufijtë e vendit tonë, në rastet e mundshme të flukseve të mëdha migratore, të papërballueshme me kapacitetet njerëzore dhe teknike të vendit tonë.

Rregullorja (EU) 2016/1624 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 shtator 2016 mbi Kufirin Evropian dhe Rojën Bregdetare Evropiane ka zgjeruar detyrat e Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Për të pasqyruar këto ndryshime, ajo është riemëruar Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian.

Kjo agjenci ka si detyrim inkurajimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit teknik dhe operativ ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta. Gjithashtu, agjencia krijon mundësinë e bashkëpunimit me vendet e treta, e cila realizohet nëpërmjet marrëveshjeve specifike të punës.

Agjencia mundëson koordinimin në kuadrin e bashkëpunimit operacional në lidhje me menaxhimin e kufijve të jashtëm ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta. Ajo mund të kryejë aksione në kufijtë e jashtëm, që përfshijnë një ose më shumë shtete anëtare dhe një vend të tretë, i cili është fqinj me, të paktën, një prej këtyre shteteve anëtare. Ky i jep mundësi agjencisë të ndihmojë edhe vendin tonë në menaxhimin e kufijve dhe të flukseve të migracionit.

Sipas Rregullores (EU) 2016/1624, marrëveshja do të mbulojë fushën e veprimit, përgjegjësinë civile dhe penale, detyrat dhe kompetencat e anëtarëve të ekipit, si dhe pajtueshmërinë me të drejtat themelore të njeriut.

Marrëveshja do të zbatohet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe do të mbulojë të gjitha aspektet e nevojshme për kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë, që do të zhvillohen në vendit tonë.

Marrëveshja trajton: rregulla mbi detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarë të ekipit dhe personelit të Agjencisë; privilegjet dhe imunitetet e anëtarëve të ekipit ku përfshihet imuniteti nga juridiksioni penal, civil dhe administrativ; përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat dhe tarifatat doganore, si dhe rregulla për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Autoriteti kompetent për zbatimin e kësaj marrëveshje për Republikën e Shqipërisë do jetë Ministria e Brendshme.

Kjo marrëveshje do t'i hapë rrugë bashkëpunimit në fushat e shkëmbimit të informacionit, analizës së riskut, trajnimit, kërkimit, zhvillimit të projekteve pilot, dhe operacioneve të përbashkëta.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.269, datë 16.05.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar në datën 5 tetor, në Tiranë. Kjo marrëveshje parashikohet të hyjë në fuqi pas ratifikimit/pranimi nga palët pjesëmarrëse në përputhje me procedurat e tyre të brendshme.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatorja u vlerësua rëndësia e marrëveshjes në kuadër të rritjes së bashkëpunimit të vendit tonë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian në luftën kundër migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

Gjatë prezantimit të këtij projektligji znj. Voda, solli në vëmendje të anëtarëve të Komisionit, se ratifikimi i kësaj marrëveshje përbën një nga objektivat e strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të rritjes së nivelit të bashkëpunimit me vendet e Bashkimit Evropian lidhur me menaxhimin e kufijve.

Anëtarët e Komisionit, kërkuar informacion mbi privilegjet dhe imunitet e njohura për personelin e Agjencisë sipas marrëveshjes si dhe me faktin nëse marrëveshja statutoe me Agjencinë e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian është lidhur edhe nga vende të tjera fqinje.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj marrëveshje, Komisioni vlerësoi rëndësinë që ajo paraqet në krijimin e kuadri rregullator për bashkëpunimin ndërmjet agjencisë dhe ekipeve të saj, nga njëra anë, dhe autoriteteve kompetente të vendit tonë, nga ana tjetër.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ELENA XHINA

ULSI MANJA